



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

KOMISIONI PËR SIGURINË KOMBËTARE

Tiranë më 06.07.2018
Dokument parlamentar

R A P O R T

Mbi projektligjin “Për ratifikimin e memorandumit të qëllimit, ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për instalimin dhe përdorimin e sistemit për krahasimin dhe vlerësimin e sigurt të identifikimit personal (PISCES)”

Drejtuar: Seancës Plenare

Komisioni për Sigurinë Kombëtare, bazuar në nenet 32-36 të Rregullores së Kuvendit, në cilësinë e komisionit përgjegjës shqyrtoi në mbledhjen e datës 06.07.2018 në parim, nen për nen dhe në tërësi, projektligjin “*Për ratifikimin e memorandumit të qëllimit, ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për instalimin dhe përdorimin e sistemit për krahasimin dhe vlerësimin e sigurt të identifikimit personal (PISCES)*”.

Qëllimi i projektligjit:

Ky projektligj ka për qëllim ratifikimin e memorandumit të qëllimit, ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, për instalimin dhe përdorimin e sistemit për krahasimin dhe vlerësimin e sigurt të identifikimit personal (PISCES).

Me anë të këtij memorandum, Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës bien dakord që kjo e fundit të instalojë Sistemin për Krahasimin dhe Vlerësimin e Sigurt të Identifikimit Personal (PISCES), për monitorimin e lëvizjes së udhëtarëve në pikat e kontrollit kufitar që do të përcaktohen bashkërisht nga palët.

Objektivat kryesorë të marrëveshjes:

Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës synon të kontribuojë në përgatitjen e infrastrukturës së ofruar nga qeveria e Shqipërisë, të nevojshme për instalimin dhe operimin e PISCES-it në mënyrë të vazhdueshme. Sistemi do të shërbejë për përmbushjen e një ndër objektivave të Ministrisë së Brendshme, sigurimin e menaxhimit të integruar të kufijve.

Me anë të këtij memorandumi do të ngrihet një sistem i cili shton disa elemente sigurie të kontrollit në pikat e kalimit kufitar. Elementi kryesor është ai i të dhënave biometrike të cilat do të identifikojnë edhe raste të vështira për t'u zbuluar nëpërmjet sistemit aktual. Gjithashtu, instalimi i këtij sistemi do të shoqërohet me një rinovim të infrastrukturës, duke pajisur çdo punonjës me kompjuter, lexues dokumentesh, lexues gjurme gishti, kamera për kontrollin e fytyrës. Këto të dhëna do të krahasohen me regjistrat e Interpolit dhe të FBI-së, duke na dhënë një përparësi në zbulimin dhe ndalimin e personave të kërkuar në nivel ndërkombëtar.

Qeveria e SHBA-ve do të sigurojë të gjitha mjetet dhe pajisjet kompjuterike që i përkasin sistemit "PISCES" dhe që importohen në dobi të qeverisë së Shqipërisë. Qeveria e Shqipërisë do të përjashtojë nga taksa e TVSH-së dhe detyrimet doganore për të gjitha mjetet dhe pajisjet kompjuterike që i përkasin sistemit PISCES dhe që importohen në dobi të qeverisë së Shqipërisë, nëpërmjet Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Nga ana tjetër, Ministria e Brendshme e Republikës së Shqipërisë ka për qëllim të vendosë në punë, të administrojë dhe të mirëmbajë pajisjet e parashikuara për sistemin PISCES, posaçërisht për qëllimet e specifikuar në memorandumin e qëllimit dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale të garantuara si për qytetarët e Republikës së Shqipërisë, ashtu edhe shtetasit e huaj që vizitojnë Shqipërinë dhe me marrëveshjet ndërkombëtare që lidhen për zbulimin dhe ndalimin e personave të kërkuar ndërkombëtarisht. Të dyja qeveritë synojnë të bashkërendohen përpara çdo transferimi apo zhvendosjeje të mjeteve dhe pajisjeve kompjuterike të PISCES

Instalimi dhe mirëmbajtja e të gjitha pajisjeve elektronike të nevojshme për funksionimin e sistemit PISCES, do të fillojë nga Aeroporti Ndërkombëtar i Tiranës duke u zgjeruar në vijim, edhe në aeroporte apo pika të tjera kufitare, të caktuara nga autoritetet e Republikës së Shqipërisë, në bashkëpunim me autoritetet përkatëse të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Ministria e Brendshme, në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga memorandumi, do të fillojë përzgjedhjen e personelit të qeverisë pritëse për të operuar dhe mirëmbajtur sistemin PISCES, me kusht që qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës të ketë si qëllim trajnimin e këtij personeli për të krijuar një kuadër të kualifikuar për këtë sistem.

Ministria e Brendshme e Republikës së Shqipërisë dhe qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës synojnë të bashkërendojnë rishikime periodike në mënyrë që të

inventarizohen dhe të përditësohen mjetet dhe pajisjet kompjuterike të siguruara nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës për sistemin PISCES.

Projektligji përmban dy nene në të cilët parashikohet:

Neni 1, përcakton ratifikimin e memorandumit të qëllimit, ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për instalimin dhe përdorimin e Sistemit për Krahësimin dhe Vlerësimin e Sigurt të Identifikimit Personal (PISCES), sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Në nenin 2 është përcaktuar hyrja në fuqi e projektligjit.

Në përfundim të diskutimeve, Komisioni për Sigurinë Kombëtare duke vlerësuar rëndësinë e kësaj marrëveshje dhe përfitimeve të shumta që sjell për shtetin shqiptar, me shumicën e anëtarëve miraton projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi si dhe shprehet dakord për kalimin e këtij pr/ligji në seancë plenare.

Relator

Kryetar

Xhemal Qefalia

Ermonela (Felaj) VALIKAJ